



Datë: 30.05.2025

Numër Protokolli: 3793/2025

A.nr.547/2025

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj–Demi, anëtare, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.547/2025 të datës 25.03.2025 të parashtruar nga ankuesja O.U., kundër organit të punësimit: Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.547/2025, e datës 25.03.2025, e parashtruar nga ankuesja O.U.

II. Mbetet në fuqi, Njoftimi me numër protokolli 14/2025, i datës 04.03.2025, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit fitues për pozitën “*Zyrtar Ligjor*”.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, O.U. (në *tekstin e mëtejme referuar*: Ankuesja), më datë 25.03.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1983/2025 në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00015457, për pozitën e punës “*Zyrtar Ligjor*”, në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik.

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në *tekstin e mëtejme referuar*: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komisioni Rregullativ të Prokurimit Publik (në *tekstin e mëtejme referuar*: KRPP), ndërsa ky i fundit, më datë 30.04.2025, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Tutje, Kryetari i Këshillit, me vendim me numër protokolli 3069/2025, të datës 07.05.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.547/2025, të parashtruar nga ankuesja edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit*) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1983/2025 të datës 25.03.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshill; Vendimin me numër protokolli 06/2025 të datës 27.01.2025; Akt emërimit me Nr.14/2024 të datës 26.09.2024; Akt emërimit me Nr.04/2025 të datës 12.03.2025; Vendimin me Nr.80/2024 të datës 01.10.2024; Akt emërimit me Nr.05/2025 të datës 12.03.2025; Akt emërimit me Nr.12/2024 të datës 16.10.2024; Dokument identifikimi; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë; Konkursin me numër reference RN00015457 të datës 15.10.2024; Listën e aplikantëve, të aprovuar dhe refuzuar; Aplikacionin e ankueses të datës 28.10.2024, së bashku me shkresat e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatit Q.R, të datës 24.10.2024, së bashku me shkresat e bashkangjitura; Testet me shkrim, formularët e vlerësimit të eses dhe intervistës me gojë; Rënditjen përfundimtare të kandidatëve, të datës 03.03.2025; E-mailin e datës 21.03.2025 dhe 19.03.2025.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankueses, **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rrjedhë se Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, më datë 15.10.2024 ka shpallur Konkursin me numër reference RN00015457, për pozitën e punës *Zyrtar Ligjor*-Klasa Profesional 2, me afat aplikimi nga data 16.10.2024 deri me datë 14.11.2024.

Me tej, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë 42 kandidatë, ku prej tyre 3 kandidatë janë përfshirë në listën e ngushtë, si kandidatë që kanë plotësuar kriteret për pozitën e shpallur, duke përfshirë këtu edhe ankuesen O.U, e cila ka marrë pjesë në të gjitha fazat e vlerësimit të procedurës përkatëse të rekrutimit, duke u renditur si kandidatja e dytë me gjithsejtë 70.6 pikë të përgjithshme, pas kandidatit Q.R, me gjithsejtë 71.2 pikë të përgjithshme, i cili sipas Njoftimit me numër protokolli 14/2025, të datës 04.03.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në KRPP, është shpallur kandidati fitues për pozitën e punës *Zyrtar Ligjor*.

Ankuesja, kundër njoftimit të lartë theksuar ka parashtruar ankesë në Këshill, mbi pretendimet ankimore se Komisioni i Pranimit nuk ka qenë në pajtim me kërkesat ligjore të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyratë Publike, andaj kërkon aprovimin e ankesës dhe anulimin konkursit përkatës.

Kolegji i Këshillit, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen e Konkursit me numër reference RN00015457, për pozitën e punës *Zyrtar Ligjor*, Klasa Profesional 2, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar: Diplomën e arsimit të**

*lartë e nivelit të parë (Bachelor) në Juridik; **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku një (1) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Rrjedhimisht, me qëllim të shqyrtimit meritorisht të pretendimeve ankimore të parashtruar nga ankuesja, dhe konstatimit se kandidatët për emërimin në këtë pozitë të pune janë vlerësuar nga Komisioni Profesional, Kolegji i Këshillit, ka analizuar përbërjen e Komisionit të Pranimit, të themeluar sipas Vendimit me numër protokolli 06/2025 të datës 27.01.2025, të Kryetarit të KRPP-së, si rrjedhojë ka konstatuar se përbërja e Komisionit, është në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktuara nga neni 40, paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: *1. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për pranim në shërbim civil në pozitë të kategorisë profesionale bëhet nga komisioni i pranimit. 2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës/ës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësuese/ës nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunës/ës i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale.; dhe në pajtim me nenin 22 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ngase thënë më konkretisht për vlerësimin e kandidatëve për pozitën lirë të punës Zyrtar Ligjor-Klasa Profesional 2, kanë marrë pjesë këta nëpunës civil të KRPP-së: z. I.R, i cili sipas Akt emërimit me Nr.14/2024 të datës 26.09.2024 mbanë pozitën e punës *Udhëheqëse i Divizionit për Interpretim*; z. O.B, i cili sipas Akt emërimit Nr.04-2025 të datës 12.02.2025, mbanë pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit për Monitorim dhe Mbikëqyrje*; znj. A.R, e cila sipas Vendimit me Nr.86/2024 të datës 01.10.2024, konstatohet se nga pozita *Zyrtare e Lartë Ligjore*, është caktuar Ushtruese e Detyrës e *Udhëheqëses së Divizionit për Legjislacion*; znj. P.S, e cila sipas Akt emërimit me Nr.05/2023 të datës 12.03.2025, mbanë pozitën e punës *Menaxhere e Personelit*; si dhe znj. H.G, e cila sipas Akt emërimit me Nr.12/2024 të datës 16.10.2024, mbanë pozitën e punës *Zyrtare e Lartë për Monitorim*.*

Tutje, Kolegji i Këshillit, në kontest të procedurës përkatëse të rekrutimit i'u referua legjislacionit në fuqi, respektivisht Nenit 39 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe dispozitave të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht Nenit 9 ku përcaktohet se: *1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën apo grupin e pozitës përkatëse. 3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë. 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim. 5. Komisioni i Pranimit në përbërje të plotë është i obliguar ditën e zhvillimit të testimit me shkrim të përzgjedhë nga bankat e pyetjeve që disponon Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për rekrutim. 6. Testi me shkrim përban gjithsej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 7. Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) minuta. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimit, vlerësojnë testin*

me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimit. 9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuara nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim....., dhe se nga analizimi i shkresave të lëndës kandidatëve lidhur me procedurën përkatëse të rekrutimit rezulton se vlerësimi i testit me shkrim është realizuar në mënyrë elektronike, dhe se pyetjet e testit kanë qenë të njëjta për gjithë kandidatet, ndërsa nga provat e pranuar nga organi i punësimit, rrjedh se ankuesja ashtu sikurse kandidati i përzgjedhur i janë nënshtruar testit me shkrim, ku ankuesja nga kjo fazë e vlerësimit në fazën e testimit me shkrim ka arritur t'i mbledh 55.4 pikë, nga rrjedh se e njëjta sikurse edhe kandidati Q.R me gjithsejtë 53.8 pikë të arritura nga kjo fazë vlerësimi kanë arritur t'i marrin pikët e mjaftueshme për të kaluar pragun e kalueshmërisë dhe rrjedhimisht për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit, gjegjësisht intervistën me gojë, sikurse parashihet me dispozitat e Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 9 paragrafi 4 ku përcaktohet se: 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim., dhe se në këtë kuptim e njëjta ka vazhduar me fazën e intervistës me gojë, ku nga kjo fazë finale e vlerësimit ka arritur gjithsejtë 15.2 pikë, duke arritur kështu gjithsejtë 70.6 pikë të përgjithshme nga kjo procedurë rekrutimi, ndërsa kundër kandidati Q.R, nga kjo fazë vlerësimi ka arritur 17.4 pikë, duke arritur kështu gjithsejtë 71.2 pikë të përgjithshme nga kjo procedurë rekrutimit, dhe duke qenë se i njëjti me rastin e aplikimit për konkursin përkatës me prova konkrete ka dëshmuar se plotëson kërkesat e përgjithshme formale të përcaktuara si më sipër, sepse ka bashkangjitur Diplomën me Nr.7639, të lëshuar me datë 04.10.2021, nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", përmes së cilës konstatohet se i njëjti me datë 02.09.2021, mbaroi studimet në Fakultetin Juridik, duke fituar kështu titullin Jurist i Diplomuar-Bachelor, ndërsa sa i përket plotësimit të kriterit prej një (1) viti përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës, kandidati në fjalë ka bashkangjitur Letër referencën/rekomandimin e lëshuar më datë 02.09.2022, nga Përmbaruesit Privat D.B., përmes të cilit dokument dëshmohet se i njëjti nga data 02.09.2021 e deri më 02.09.2022 (1 vit), ka qenë i angazhuar në cilësinë e praktikantit pranë kësaj zyre, si rrjedhojë i njëjti ka fituar të drejtën për tu shpallur kandidat fitues, në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: 1. Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të vlerësimit. 2. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNj, emrin dhe mbiemrin e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat.

Kolegji i Këshillit, duke bazuar në rrethanat dhe konstatimet si më sipër, konstaton se Komisioni i Pranimit dhe rrjedhimisht Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në KRPP, me rastin e zhvillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën përkatëse të punës, ashtu sikurse edhe shpalljen e Njoftimit me numër protokolli 14/2025 të datës 04.03.2025, për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit fitues për pozitën *Zyrtar Ligjor-Klasa Profesional 2*, ka zbatuar drejtë ligjin material, duke

vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Njoftimit m me numër protokolli 14/2025 i datës 04.03.2025, për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit fitues për pozitën e punës *Zyrtar Ligjor*, në Divizionin për Interpretime të Departamentit të Rregullave në KRPP, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.547/2025

Atdhe GASHI

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Procesmbajtës

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses O.U.;
- Udheheqësit të Burimeve Njerëzore në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.